UDHËZIM
Nr.7, datë 29.10.1992

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.2, DATË 4.1.1992

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 4.1.1992 "Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personave të dënuar me heqje të lirisë, me internim ose dëbim për motive politike, u jepet pension mesatar, kur nuk kanë mundësi ose nuk kanë interes të zgjedhin pagën mesatare.".

2. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Koha e vuajtjes së dënimit për të internuarit dhe të dëbuarit njihet si vjetërsi pune për efekt pensioni sipas kategorisë që ka puna e kryer para fillimit të dënimit, pavarësisht nëse ka punuar ose jo gjatë vuajtjes së dënimit, kur ajo (puna e kryer) nuk ka qenë e ndonjë kategorie më të lartë.".

3. Në pikën 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Komisioni i krijuar nga Ministria e Rendit dhe Ministria e Drejtësisë, duke u mbështetur në vendimet gjyqësore, lëshon vërtetime për veprën penale konkrete, në bazë të së cilës është dhënë vendimi. Ky vërtetim shërben si dokument zyrtar për organet e sigurimeve shoqërore.".

4. Pas pikës 7 shtohen pika 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

8. "Personat që përfitojnë nga nenet 1 dhe 6 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991, në bazë të kërkesës së tyre, u jepet përkatësisht pensioni që u takon nga koha e lindjes të së drejtës (edhe mbi 3 vjet), si dhe diferenca ndërmjet pensionit që u takon dhe pensionit minimal që u është dhënë.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen organet e Institutit të Sigurime Shoqërore.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi